



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, 17 qershor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Rita Hajzeraj, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Mimoza Ahmetaj, Bujar Bukoshi, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Sadik Idriz dhe Sllobodan Petroviq.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative.

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Gjylnaze Novobërdaliu-Gola dhe Minire Begaj.

Nga Ministria e Shërbimeve Publike: Sylejman Gashi

Munguan: Përfaqësuesit nga Ministria për Ekonomi dhe Financa,

Nga NDI-Shefki Kastrati,

Nga USAID-Haxhi Gashi,

Nga zyra e Presidentit të Kosovës -Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi znj. Rita Hajzeraj, zëvendëskryetare e parë e Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë - ishin të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe të Ministrisë së Shërbimeve Publike.
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Qamile Morina - Tha se në mbledhjen e kaluar, në pikën e fundit të rendit të ditës, në të ndryshme, ka propozuar që të planifikohet një vizitë në një qendër spitalore dhe një vizitë në pjesën veriore të Mitrovicës. Lidhur me implikimet buxhetore për Ligjin e punës ajo ka thënë se sponsoruesi ka dhënë shpjegime për vitet 2008 - 2010 dhe komenti i saj ka qenë: buxheti për MPMS-në nga viti i kaluar është rritur nga 149 milionë në 175 milionë.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtjen e mësipërme.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë – ish-in të ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe të Ministrisë së Shërbimeve Publike

Rita Hajzeraj - Tha se Projektligji për punën është shqyrtuar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, para leximit të parë, si dhe e ka kaluar leximin e parë në seancë plenare. Komisioni gjatë shqyrtimit ka vlerësuar se ky projektligj ka dilema rreth: implikimeve buxhetore, politikave të sponsoruesit, si dhe kategorisë së punëtorëve të përfshirë me këtë ligj. Ky Projektligj a e përfshin vetëm kategorinë e punëtorëve të sektorit privat? Si do të rregullohet statusi i punëtorëve në sektorin publik, ku do të përfshihet kategoria e punëtorëve të shëndetësisë dhe e punëtorëve të arsimit? Ajo e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Armend Zemaj - Tha se ajo që është diskutabile lidhur me Projektligjin e punës është mospërfshirja e të gjitha kategorive të punëtorëve me këtë ligj. Nëse analizohet me vëmendje, ky projektligj është ligj mbi kontratën e punës.

Ajo çka i intereson këtij komisioni është: si dhe pse me këtë ligj nuk është përfshirë kategoria e shërbyesve civilë, si dhe cilat kategori të të punësuarve i përfshin ky ligj?

Flora Brovina - Ligji i Punës është bazik dhe patjetër duhet të ketë mbulesë financiare. Ky projektligj i ka defektet e veta. Së pari ky ligj nuk është ligj i punës, por është ligji i punës të një sektori të veçantë. Ajo e parashtrroi pyetjen, a do të jenë edhe kategoritë e tjera të punëtorëve në kuadër të këtij ligji apo jo?

Po ashtu tha se duhet të diskutohet rreth titullit të këtij ligji, pasi nuk i përfshin të gjitha kategoritë e të punësuarve.

Rita Hajzeraj - Propozoi që ky të mos quhet ligj bazik i punës, por ligji i punës për sektorin privat.

Mimoza Ahmetaj - Tha se në këtë projektligj, përveç shërbyesve civilë, nuk janë përfshirë: arsimi, shëndetësia, TMK-ja dhe gjykatat. Janë disa kategori të punëtorëve, për të cilat ajo ka dilema se ku do të mbeten. Pastaj, në këtë projektligj, përmendet sigurimi shëndetësor, edhe pse Kosova nuk ka sigurim shëndetësor. Parashtrroi pyetjen: si është paraparë me këtë projektligj sigurimi shëndetësor për kategorinë e punëtorëve që i përfshin?

Teuta Hadri - Tha se Projektligji i punës, që është proceduar në Kuvend në këtë mandatë, duke e krahasuar me Projektligjin që ka qenë i bazuar në Rregulloren 2001/27, është më i mirë, sepse përfshin njerëz të kategorisë së caktuar. Ajo i ka dy dilema: Çdo ligj që bëhet duhet ta ketë strategjinë e vet. Ky ligj a do të jetë gjithëpërfshirës, pra i të gjithë sektorëve në Kosovë apo do të jetë ligj që i shqyrton kategoritë e të punësuarve veç e veç? Ky projektligj është bazuar në dy sisteme: në sistemin francez, duke tentuar që ky ligj të jetë gjithëpërfshirës dhe në metodën sllovene që i rregullon marrëdhëniet e punës me ligje të veçanta për secilën kategori të punëtorëve. Ajo i ftoi përfaqësuesit e ministrive t'i paraqesin paqartësitë që dalin sipas këtij projektligji. Ky ligj i rregullon marrëdhëniet e punës në sektorin publik - në njërin anë - kurse në anën tjetër futen edhe disa kategori, si: kujdestaritë të punëtorëve të shëndetësisë të shërbimit civil. Si do të rregullohet pagesa e punëtorëve të shëndetësisë?

Nurishahe Hulaj - Në këtë projektligj thuhet se sipas interpretimit të MPMS-së dhe MSHP-së në shërbimin civil të Kosovës nuk përfshihen të punësuarit e arsimit dhe të shëndetësisë që trajtohen si të punësuar publikë. Ajo e parashtrroi pyetjen: Ky ligj a do të jetë i adresuar edhe në këto dy shtylla? Po ashtu kërkoi informacion nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale për mjetet financiare për zbatimin e këtij ligji. Mjetet e parapara në shkresat përcjellëse të këtij projektligji, a do të jenë të alokuara sipas viteve të paraqitura në këto shkresa?

Qamile Morina - Tha se shfaqen dy dilema sa i përket këtij projektligji. E para ka të bëjë me sqarimin e nocioneve: shërbyes civil dhe shërbyes publik. Dilema e dytë ka të bëjë me implikimet buxhetore. Nëse Komisioni arrin t'i heqë këto dilema, ajo beson se ky ligj do të bëhet i zbatueshëm. Synimi kryesor është që ky ligj të bëhet i zbatueshëm.

Gjylnaze Novobërdaliu-Gola – Tha se praktikat themelore lidhur me këtë projektligj janë marrë nga Kroacia. Ky ligj i rregullon marrëdhëniet e punës ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit në sektorin privat, si dhe në sektorin publik. Në sektorin publik hyjnë edhe punëtorët e shëndetësisë dhe të arsimit. Dilemat kanë qenë nëse shërbyesit civilë duhet të trajtohen si kategori e veçantë, nëse do të merrej parasysh përvoja e vendeve të tjera. Por edhe Ligji për shërbyesit civil, sa u përket pushimeve të lehonisë dhe dispozitave të përgjithshme, do t'i referohet Ligjit themelor të punës. Çështja e sigurimit shëndetësor është e paraparë të rregullohet me ligj të veçantë.

Minire Begaj - Marrëdhëniet e punës janë një - janë rregulla të përgjithshme për punësim që vlejné në të gjithë sektorët dhe për të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit. Specifikat e shërbyesve civilë i bëjnë të dallohen nga punëtorët publikë. Në draftin që ka qenë në shqyrtim në mandatin e kaluar ka qenë një dispozitë që i referohej Ligjit për shërbyesit civil, si ligj i veçantë, por kjo dispozitë nuk figuron në Projektligjin që është tani në shqyrtim. Ajo konsideron se një përjashtim i tillë është shumë i vrazhdë. Tha se ky ligj është bazik, që në vete do të ngërthente edhe shumë ligje të tjera. Fakti që ky, është ligj i punës, atëherë të gjitha ligjet e tjera edhe Ligji i shërbyesve civilë, besoj do t'i referohet këtij ligji, sepse ky ligj i rregullon marrëdhëniet e punës. Sa u përket implikimeve buxhetore, mjetet financiare për këtë ligj janë alokuar. Ky ligj është paraparë në KASH, por ajo nuk ka informata se si ka vendosur KASH-i.

Sylejman Gashi - Tha se në Ministrinë e Shërbimeve Publike është duke u punuar në Ligjin për shërbyesit civil. Ai beson se shumë shpejt do të procedohet në Kuvend dhe me siguri do të marrë dispozita edhe nga Ligji i punës. Për hir të specifikave që ka kategoria e punëtorëve shërbyes civilë, duhet të trajtohet me ligj të veçantë. Kjo është edhe praktikë e vendeve në rajon.

Gjylnaze Syla - Tha se nga përmbajtja e këtij projektligji, kuptohet se ky ligj është vetëm për sektorin privat. Ky projektligj nuk e përfshinë kategorinë e mjekëve, si dhe nuk e ka definuar statusin e mjekëve dhe të punëtorëve të arsimit. Ishte e mendimit se në këtë ligj duhet të inkorporohen edhe dy nene që do ta specifikonin që me ligj të veçantë të rregullohet statusi i shërbyesve civilë dhe statusi i punëtorëve në sektorin publik. Ajo nga përfaqësuesit e MPMS-së kërkoi sqarime, se çka përfshin ky ligj.

Pas diskutimeve të përfaqësuesve të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe të Ministrisë së Shërbimeve Publike, si dhe pas diskutimeve të deputetëve, Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Ministria e Punë dhe e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shërbimeve Publike, vërejtjet dhe propozimet e veta që kanë të bëjnë me Ligjin e punës, do t'i dorëzojnë me shkrim, në mënyrë që Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit të punës t'i shqyrtojë edhe vërejtjet dhe propozimet.

4. Të ndryshme

Rita Hajzeraj - I njoftoi anëtarët e Komisionit për listën e të ftuarve në dëgjimin publik për Projektligjin e punës, që do të mbahet më 25 qershor 2008.

Ajo po ashtu propozoi që për këtë projektligj të formohen dy grupe pune. Me këtë propozim nuk u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Kryesuesja e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 12:10

Përgatitur nga

Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Rita Hajzeraj